

Putini "po i teston limitet", paralajmëron Merz



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HOVENIERI: DEKLARATAT E KURTIT KUNDËR GJYKATËS KUSHTETUESE ÇUAN NË PEZULLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK



- Ish-ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka shpjeguar se pezullimi i Dialogut Strategjik nga Shtetet e Bashkuara është pasojë e një grumbullimi frustrimesh ndaj

qeverisë së kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, ku veçanërisht ndikoi kritika e tij ndaj Gjykatës Kushtetuese. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Hovenieri

thotë se pezullimi duhet marrë seriozisht dhe e cilëson si një "humbje të madhe mundësie" për forcimin e partneritetit në mes të Kosovës dhe ShBA-së

RUBINI PËRFUNDON DËSHMINË NË SPECIALE: ISHTE PRIVILEGJ PËR MUA TË JEM KËTU F. 7



KCSF: KONSULTIMI PUBLIK NË KOSOVË VETËM PROCEDURAL DHE PA PËRFSHIRJE DOMETHËNËSE TË PUBLIKUT F. 7



BE-ja SHPALOS PLANIN PËR TARIFA DHE SANKSIONE TË REJA KUNDËR IZRAELIT SHKAKU I LUFTËS NË GAZË F. 2

BISLIMI E MOHON SE KOSOVA PO I SHËNJESTRON INSTITUCIONET SHËNDËTËSORE SERBE NË VERI F. 7

ISMAILI PËR DARDANINË: DY PARKINGJE NËNTOKËSORE DHE BUXHET 14 MILIONË I NDARË VETËM PËR LAGJEN F. 7

MË PAK THËNGJILL I PRODHUAR NË KORRIK 2025 SESA NË KORRIK 2024 F. 8

BQK-ja FORCON KAPACITETET INSTITUCIONALE DREJT INTEGRIMIT NË SISTEMIN E BANKAVE QENDRORE EVROPIANE F. 8

SPORT



FC DRENICA: MBËSHITESIM 100 PËR QIND TRAJNERIN BYLBYL SOKOLI F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja SHPALOS PLANIN PËR TARIFA DHE SANKSIONE TË REJA KUNDËR IZRAELIT SHKAKU I LUFTËS NË GAZË

BRUKSEL, 17 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) e ka shpalosur të mërkurën planin e tij më të ashpër deri tani për t'i bërë trysni Izraelit që ta përfundojë luftën në Rripin e Gazës, ku palestinezët po detyrohen të ikin nga tanket, dronët dhe trupat izraelite që po futen gjithnjë e më thellë në enklavën bregdetare të shkatërruar nga lufta gati dyvjeçare.

Kaja Kallas, shefja e politikës së jashtme të BE-së, u bëri thirrje 27 vendeve anëtare t'i rrisin tarifatat ndaj disa mallrave izraelite dhe të vendosin sanksione ndaj 10 drejtuesve të Hamasit, kolonëve izraelitë dhe dy anëtarëve të kabinetit të kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu: ministrit për Siguri Kombëtare Itamar Ben-Gvir dhe ministrit të Financave Bezalel Smotrich. Hamasi është i shpallur organizatë terroriste nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara. "Ne po i propozojmë këto masa jo për ta ndëshkuar Izraelin apo popullin izraelit, por për të ushtruar trysni mbi qeverinë izraelite që të ndryshojë kurs dhe t'u japë fund vuajtjeve të njerëzve në Gazë", tha Kallas. "Lufta duhet të përfundojë, vuajtjet duhet të ndalen dhe të gjitha pengjet duhet të lirohen", shtoi ajo.

Sanksionet do të nënkuptonin ngrirje të aseteve të individëve në Evropë dhe do t'ua ndalonin atyre udhëtimin brenda BE-së. BE-ja është partnerja më e madhe tregtare e Izraelit, prandaj tarifatat mund të kenë pasojë të mëdha në ekonominë izraelite, e cila tashmë është tronditur nga kostoja e një lufte të gjatë. Rreth 32 milionë euro fonde dypalëshe të kontrolluara nga Komisioni Evropian do të pezulloheshin menjëherë. Komisioni, gjithashtu, e mbështet edhe Autoritetin Palestinez. Izraeli mohon se në Gazë ka krizë për bukë dhe thotë se lejon hyrjen e ndihmave të mjaftueshme humanitare. Ministri i Jashtëm izraelit, Gideon Saar, i dërgoi një letër presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, duke u zotuar se Izraeli nuk do t'i nënshtrohet fushatës evropiane. "Trysnia përmes sanksioneve nuk do të funksionojë. Shteti i Izraelit është komb krenar dhe sovran, dhe ne nuk do të përkulemi përballë kërcënimeve, ndërkohë që siguria e Izraelit është në rrezik", shkroi ai në letër. Bashkimi Evropian, me 27 vende anëtare, ka qenë i ndarë gjatë 23 muajve të fundit të luftës në



Rripin e Gazës. Nuk është e qartë nëse shumica e tyre do të pajtohen për t'i miratuar sanksionet dhe masat tregtare. Gjakderdhja në Gazë ka nxitur protesta në qytete të shumta evropiane, nga Amsterdam në Barcelonë, dhe ka shtuar kritikën ndaj burokracisë së Brukselit për paaftësinë e perceptuar për të ushtruar trysni të mirëfilltë mbi Izraelin që t'i ndalojë operacionet ushtarake dhe të lejojë më shumë ndihma humanitare. Numri i të vrarëve në Gazë ka kaluar shifrën mbi 67 000 palestinezë që nga fillimi i luftës më 7 tetor 2023, sipas zyrtarëve shëndetësorë të enklavës. Lufta nisi pas sulmit të udhëhequr nga Hamasi në jug të Izraelit, ku militantët vranë rreth

1 200 njerëz dhe rrëmbyen 251 të tjerë, sipas zyrtarëve izraelitë. "Pezullimi i pjesshëm i propozuar është përgjigje e menduar mirë ndaj një situatë gjithnjë e më urgjente", tha Maros Sefcovic, përfaqësuesi tregtar i Komisionit Evropian.

Çfarë përmban propozimi

Nëse mjaftueshëm vende të BE-së pajtohen, atëherë do të vendosen tarifa në vlerë rreth 230 milionë euro ndaj 37-përqindësh të mallrave izraelite, të vlefshme 15.9 miliardë euro, që i importon BE-ja, tha Sefcovic. Aktualisht BE-ja nuk vendos tarifa mbi këtë kategori mallrash izraelite falë një Marrëveshjeje Asociimi.

Një shqyrtim i bërë nga korpusi diplomatik i BE-së në qershor gjeti se Izraeli kishte shkelur komponentin e të drejtave të njeriut të kësaj marrëveshjeje, të quajtur Neni 2.

Kritikët evropianë të Izraelit kanë kërkuar që e gjithë marrëveshja tregtare të pezullohet për shkak të luftës në Gazë. Por, tani për tani, komisioni propozon ta heqë preferencën për zero-tarifë për një sasi të zgjedhur mallrash izraelite dhe t'i zbatojë tarifatat e Organizatës Botërore të Tregtisë të cilat variojnë nga 8 për qind në 40 për qind për produkte të ndryshme. "Ne nuk po propozojmë të pezullojmë tregtinë me Izraelin, por po propozojmë t'i pezullojmë preferencat tregtare", tha një zyrtar i lartë evropian i ngarkuar me komunikimin për Komisionin Evropian, i cili nuk ishte i autorizuar të fliste publikisht sipas politikës së komisionit.

Propozimi pasoi pas njoftimit të javës së kaluar nga von der Leyen, se ajo do të kërkonte sanksione dhe një pezullim të pjesshëm tregtar ndaj Izraelit për shkak të fushatës së tij ushtarake në Gazë, duke hequr dorë nga qëndrimi i saj tradicionalisht proizraelit.

PUTINI 'PO I TESTON LIMITET', PARALAJMËRON MERZI



BERLIN, 17 SHTATOR - Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz, porositi Evropën që të mos e lejojë Rusinë t'i përcaktojë kushtet e një marrëveshjeje për paqe në Ukrainë, duke paralajmëruar se një gjë e tillë vetëm sa do ta trimëronte presidentin rus Vladimir Putin "që ta kërkojë objektivin e tij të radhës". "Putini po i teston limitet që një kohë të gjatë", tha Merz në parlamentin gjerman, ku po diskutohet për buxhetin e ri. "Ai saboton, spiunon, vret, përpiket

t'i trazojë njerëzit", u shpreh kancelari i Gjermanisë të mërkurën, raporton DPA. Merz tha se kjo u bë e qartë në Poloni, javën e kaluar, kur dronët rusë cenuan hapësirën ajrore të vendit dhe u rrëzuan mbi territorin e tij për herë të parë. Putini, po ashtu, po përpiket ta destabilizojë shoqërinë gjermane, paralajmëroi kancelari Merz. "Ne nuk do të lejojmë që kjo të ndodhë", deklaroi Merz, duke shtuar se Gjermania po forcon kapacitetet mbrojtëse pikërisht për këtë

arsye. "Ne duhet t'i parandalojmë kundërshtarët tanë nga agresioni i mëtejshëm dhe, në të njëjtën kohë, t'i bëjmë më të bashkuar aleatët dhe partnerët", tha Merz. Gjermania ka qenë një prej mbështetësve më të mëdha të Ukrainës pas pushimit rus në shkallë të gjerë më 2022. Sipas ministrit gjerman të Mbrojtjes, Boris Pistorius, Gjermania ua ka kaluar Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tani është furnizuesja më e madhe e Ukrainës me ndihma ushtarake.

NAVALNY VDIQ NGA HELMIMI, THOTË BASHKËSHORTJA E TIJ

MOSKË, 17 SHTATOR - Bashkëshortja e udhëheqësit të ndjerë opozitar rus, Aleksei Navalny, tha se sipas analizave biologjike që janë dërguar për analizim pa dijeninë e autoriteteve ruse, u gjet se ai u vra përmes helmimit në shkurt të vitit 2024. Ai gjendej në një burg në Arktik kur vdiq. Kritiku shumëvjeçar i presidentit rus, Vladimir Putin, vdiq në rrethana misterioze, teksa po vuante një dënim prej 19 vjetësh burgim për një sërë akuzash që

shiheshin si hakmarrje për shkak të opozitarizmit të tij. Navalny kishte organizuar protesta në mbarë Rusinë kundër Kremlinit dhe kishte zbuluar përfitimet që kishte rrethi i ngushtë i Putinit. Aleatët e tij kanë thënë se ai është vrarë në burg dhe Moskë asnjëherë nuk e ka shpjeguar shkakun e vdekjes së tij, por vetëm ka thënë se ai u sëmure teksa po ecte në oborrin e burgut më 16 shkurt 2024. Rusia ka shtuar shtypjen e aleatëve të Navalnyt pas vdekjes

së tij, duke e shtuar Navalnayan në listën e "terroristëve dhe ekstremistëve" dhe duke dënuar avokatët e kundërshtarit të Putinit dhe gazetarët që kishin ndjekur rastet gjyqësore ndaj Aleksei Navalnyt. Shumica e familjes së tij dhe aleatëve kyçë jetojnë jashtë Rusisë. Kremlini ka përforcuar goditjen ndaj disidencës, veçmas pas nisjes së pushtimit të Ukrainës fqinje dhe në Rusi janë të rralla kundërshtimet për luftën dhe Putinin.



RUBINI PËRFUNDOI DËSHMINË NË SPECIALE: ISHTE PRIVILEGJ PËR MUA TË JEM KËTU

Ish-ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, James Rubin, për tri ditë me radhë dëshmoi për rolin e Hashim Thaçit gjatë luftës, për bisedimet në Rambuje, por edhe shprehu kritika për Dhomat e Specializuara në Hagë. Rubini e nisi dëshminë e tij më 15 shtator, duke thënë se Hashim Thaçi kishte rol kryesisht politik dhe nuk kishte kompetenca për vendime ushtarake brenda UÇK-së. Sipas tij, ai duhej ta merrte miratimin e komandantëve për çdo vendim të rëndësishëm ushtarak. Ai tha se nuk kishte asnjë informacion që lidh Thaçin apo të akuzuarin tjetër, Jakup Krasniqi, me pretendimet për vrasje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

HAGË, 17 SHTATOR - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, James Rubin ka përfunduar dëshminë treditore. “Dua të them që ishte privilegj për mua të jem këtu pavarësisht se zgjati pak më shumë, por ishte një përdorim i rëndësishëm i kohës sime”, tha Rubini.

Ish-ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, James Rubin, për tri ditë me radhë dëshmoi për rolin e Hashim Thaçit gjatë luftës, për bisedimet në Rambuje, por edhe shprehu kritika për Dhomat e Specializuara në Hagë. Rubini e nisi dëshminë e tij më 15 shtator, duke thënë se Hashim Thaçi kishte rol kryesisht politik dhe nuk kishte kompetenca për vendime ushtarake brenda UÇK-së. Sipas tij, ai duhej ta merrte miratimin e komandantëve për çdo vendim të rëndësishëm ushtarak. Ai tha se nuk kishte asnjë informacion që lidh Thaçin apo të akuzuarin tjetër, Jakup Krasniqi, me pretendimet për vrasje.

Rubini tha se ndërmjetësi i ShBA-së në Rambuje, Christopher Hill, kishte bërë përpjekje që të dëmtonte figurën e tij dhe të sekretares së Shtetit, Madeleine Albright. Sipas tij, Hilli ishte “në favor të LDK-së dhe kundër UÇK-së”. Ai u pyet edhe për rolin e Adem Demaçit brenda UÇK-së. Rubini tha se ndikimi i Demaçit, që kundërshtoi marrëveshjen e Rambujesë, ishte ideologjik dhe joekzekutiv dhe se angazhimet e Shteteve të Bashkuara ishin ato që, në fund, i mundësuan Hashim Thaçit ta kapërcente rezistencën e tij.

Në ditën e dytë të dëshmisë, Rubini tha se përshtypja fillestare e ShBA-së për UÇK-në ishte se ajo ishte organizatë me aktivitetet terrorist, por kjo përshtypje ndryshoi, pasi ajo u pajtua me marrëveshjen e Rambujesë. Ai ishte kritik ndaj Gjykatës Speciale duke e cilësuar si të padrejtë mbajtjen për pesë vjet në paraburgim të katër të akuzuarve, që Rubini tha se u dorëzuan vullnetarisht. Rubini, gjithashtu, dëshmoi se nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK dhe

se si ShBA-ja e konsideronte Thaçin si udhëheqës të caktuar nga vetë shqiptarët.

Ndërkaq, në ditën e tretë dhe të fundit, Rubini bëri disa sqarime për deklaratimet e tij para Gjykatës. Ai sqaroi se nuk e di nëse Thaçi ka përdorur emrin “tradhtar” nëse do ta pranonte marrëveshjen, por tha se kjo mund të ketë qenë më shumë perceptimi i tij. Ai, po ashtu, tha se komunikatat e lëshuara nga UÇK-ja ishin më shumë përpjekje për ta bërë UÇK-në më të rëndësishme sesa ishte.

RUBINI THEKSOI NUK MENDONTE SE THAÇI ISHTE NDONJË KOMANDANT KRYESOR I UÇK-SË

Rubini: Donim që Thaçi të kthehej në një udhëheqës që e drejton kombin drejt lirisë

Gjykatësi nga Irlanda, Fergal Gaynor, ka nisur të mërkurën pyetjet e tij drejtuar James Rubinit. Ai lëshoi një pjesë të një dokumentari të vitit 2000 të publikuar nga BBC, ku ish-sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, i referohet Thaçit si lider.

Gjykatësi tha se dje Rubini deklaroi se Adem Demaçi ishte lider.

Rubini u përgjigj se Demaçi ishte një person me status të lartë në Kosovë, në lartësinë e Nelson Madelës. Por, ai korrigjoi gjykatësin sa i përket deklaratës së Albrightit. “Unë mendoj që ajo ka zgjedhur me kujdes fjalët e saj. Ajo nuk tha lideri, por një prej liderëve. Dhe ka një dallim të madh. Ajo e krahasoi me Gary Adams. Një lider që e drejtoi kombin drejt lirisë”, tha Rubini. “Ne donim që ai të kthehej në udhëheqës i një kombi, që me shpresë do të ishte i lirë. Po ju korrigjoj, ajo tha një drejtues të një grupi. Një drejtues i një delegacioni që ishte zgjedhur nga delegacioni shqiptar. Ai ishte një prej. Kishte një pozicion udhëheqës. Edhe nëse ka thënë udhëheqës i delegacionit, kjo është e saktë”, shtoi Rubini. Gjykatësi, po ashtu, e pyeti Rubinin nëse ishte në dijeni se Thaçi kishte



kërcënuar anëtarë të delegacionit të Kosovës në Rambuje, që nuk ishin pjesë e UÇK-së, për mbështetjen e tyre për një marrëveshje [kur Thaçi ishte kundër saj], pasi paraprakisht, në një video të transmetuar, u shfaqën Veton Surroi dhe Dukagjin Gorani duke folur në një dokumentar. “Kushdo që e nënshkruan atë, do ta trajtoj apo do ta konsideroj si armik - si armik të kombit”, është shprehur Dukagjin Gorani në dokumentar, duke cituar Thaçin.

Rubini ka thënë se nuk ka qenë në dijeni për kërcënime fizike. “Ta ndajmë kërcënimin fizik, nga ai moral. Jo, nuk e kam ditur që ka pasur kërcënim fizik, por e di që ka pasur presion ideologjik pro ose kundër pavarësisë sepse kjo ishte kryesorja për lëvizjen gjatë luftës. Kështu që Albright e ka kërcënuar Thaçin, duke i thënë se nëse nuk nënshkruan, nëse i lë njerëzit e pambrojtur nga serbët... kam dëgjuar edhe se është kërcënuar edhe Demaçi”, tha Rubini.

James Rubini ka vazhduar të dëshmojë se, sipas tij, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kishte strukturë të organizuar siç e kanë ushtritë. Ai tha se kishte më shumë grupe, klane, por jo strukturë të mirëfilltë ushtarake. “Me sa pashë unë nuk ka pasur batalione, brigada apo njësi në UÇK, nuk besoj se ka pasur organizim nga pikëpamja ushtarake”, tha Rubini. Ai mohoi të kishte dijeni se në UÇK kishte polici ushtarake. “Unë e di që kishin uniforma, disa kishin disa jo. Ne nuk i konsideronim ata si komandantë apo shtab i përgjithshëm”.

Në lidhje me komunikatat e

UÇK-së, Rubini tha se ka lexuar shumë prej tyre, por tha se i dukeshin si përpjekje për ta bërë UÇK-në më të rëndësishme sesa ishte. “Për mua ishin thjesht manipulime”, shtoi ai.

“Kam lexuar shpesh komunikata [të UÇK], por më dukeshin si përpjekje për ta bërë UÇK-në më të rëndësishme se ç’ishte. Për mua ishin thjesht manipulime”, tha Rubini. Gjatë pyetjeve të mbrojtjes së Thaçit, Rubini rikujtoi edhe njëherë ditët e marrëveshjes së Rambujesë, komunikimet me Thaçin, teksa sqaroi edhe njëherë fjalën “tradhtar” që ai e përdori në fillim të dëshmisë. Ai kishte deklaruar se kështu do të quanin Hashim Thaçin nëse ai do ta pranonte marrëveshjen pa u përmendur pavarësia e Kosovës.

Rubini tha se ky moment që ishte përshkruar të një artikull të tij, ishte përkthyer më pas në shqip e më pas ishte bërë pjesë e një libri dhe mund të kenë ndryshuar fjalët. Sipas tij, ky epitet se Thaçi do të quhej tradhtar mund të ketë qenë më shumë perceptim i tij sesa vetë deklaratë e Thaçit. “Nuk imagjinoj që ta ketë quajtur veten tradhtar, por unë po përpiqesha të bëja një përmbledhje të asaj çështje. Fjala që kam zgjedhur bazohej në vlerësimin që kam bërë. Megjithatë e di se ai ishte në një presion të madh”, tha Rubini.

Rubini tha se ishte një përpjekje e senatorëve amerikanë dhe të administratës Clinton që delegacioni i UÇK-së ta nënshkruante marrëveshjen e Rambujesë.

Avokati i Thaçit kujtoi se Demaçi, që ishte kundërshtar i marrëveshjes së Rambujesë dha

dorëheqje më 2 mars. Ai e pyeti Rubinin pse ishte e nevojshme që senatori republikan Bob Dole të vizitonte, ra Demaçi më 2 mars, dorëheqje, pengesë - pse doli udhëtoi në rajonin më 5 mars, pasi më nuk ekzistonte një pengesë e tillë Rubini tha se Dole përkrahte politikën e administratës Clinton dhe po tentonte të sigurohej që delegacioni i UÇK-së ta pranonte marrëveshjen. Sipas tij, ishte e rëndësishme që të mbaheshin sa më shumë takime edhe me personat më skeptikë të kësaj marrëveshjeje, që ajo të nënshkruhej. “Ishte një përpjekje gjithëpërfshirëse, e senatorëve, të mia dhe Chris Hill”, tha Rubini. Avokati i Thaçit, Misheti, ka vazhduar me pyetjet drejtuar Rubinit. Ai e pyeti nëse e dinte se ku gjendej Thaçi nga nëntori i vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999. Rubini përsëriti se nuk dinte për lëvizjet e tij, “por besoj se kur kam folur [në telefon] ka qenë në Kosovë. Pra, në kohën e bombardimeve”.

Më pas Misheti citoi një intervistë të Hillit të dhënë më 2002, kur ishte pyetur se ku ishte Thaçi. Hilli kishte thënë se atëbotë edhe senatori Dole kishte parashtruar këtë pyetje dhe atij i ishte thënë se Thaçi do të kthehej në Kosovë. Hilli kishte shtuar se ky ishte një indikacion se “Thaçi s’kishte mandat”.

Rubini u pajtua. “Absolutisht pajtohen. Thaçi nuk ka qenë asnjë lloj komandanti kryesor”, tha ai.

Pas Rubinit, në Hagë po vazhdon dëshminë e radhës të mbrojtjes së Thaçit, Paul Williams, juristin amerikan që kishte qenë këshilltar ligjor i delegacionit të Kosovës gjatë negociatave në Rambuje.



HOVENIERI: DEKLARATAT E KURTIT KUNDËR GJYKATËS KUSHTETUESE ÇUAN NË PEZULLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ish-ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka shpjeguar se pezullimi i Dialogut Strategjik nga Shtetet e Bashkuara është pasojë e një grumbullimi frustrimesh ndaj qeverisë së kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, ku veçanërisht ndikoi kritika e tij ndaj Gjykatës Kushtetuese. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Hovenieri thotë se pezullimi duhet marrë seriozisht dhe e cilëson si një "humbje të madhe mundësie" për forcimin e partneritetit në mes të Kosovës dhe ShBA-së.

Më 12 shtator ShBA-ja pezulloi dialogun strategjik me Kosovën, duke arsyetuar vendimin me veprimet e qeverisë në detyrë dhe me rritjen e tensioneve dhe paqëndrueshmërisë në vend. Qeveria në detyrë e Kosovës i hodhi poshtë kritikën e ShBA-së, duke thënë se "veprimet tona, të ligjshme dhe kushtetuese, përgjatë gjithë kohës kanë qenë në shërbim të eliminimit të vatrave të destabilitetit". "[Dialogu Strategjik] do të ishte një hap i rëndësishëm për Kosovën, dhe është për keqardhje që nuk do të ndodhë. Kjo nuk do të thotë se bashkëpunimi i vazhdueshëm është pezulluar ose dëmtuar, por do të thotë se një mundësi për ta

rritur dhe forcuar atë, për momentin, është ngrirë. Kjo duhet ta tërheqë vëmendjen e të gjithëve që brengosen për fuqinë dhe vitalitetin e marrëdhënies", thotë Hovenieri, tani bashkëpunëtor i lartë jorezident në Qendrën për Evropë të Këshillit Atlantik.

Ambasador Hovenier, sa serioz është vendimi i Uashingtonit për ta pezulluar Dialogun Strategjik me Kosovën?

Hovenieri: Mendoj se duhet marrë seriozisht. Dialogu Strategjik është një instrument diplomatik, që Shtetet e Bashkuara e përdorin për t'i avancuar marrëdhëniet dypalëshe me vende të ndryshme. Ai përfshin diskutime në nivel të lartë mbi një agjendë të gjerë, të përcaktuar paraprakisht. Ne nuk kemi pasur më parë Dialog Strategjik formal me Kosovën. Por, jemi angazhuar në procese të tilla me disa vende në Evropën Juglindore: Bullgarinë, Rumaninë, Greqinë, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut. Në to trajtohen gjëra si: siguria, mbrojtja, siguria energjetike, tregtia, investimet, siguria kibernetike, lidhjet mes njerëzve. Ideja është që të promovohen stabiliteti dhe prosperiteti, pjesëmarrja ose integrimi më i

thelluar në institucionet evropiane dhe euroatlantike. [Dialogu Strategjik] do të ishte një hap i rëndësishëm për Kosovën, dhe është për keqardhje që nuk do të ndodhë. Kjo nuk do të thotë se bashkëpunimi i vazhdueshëm është pezulluar ose dëmtuar, por do të thotë se një mundësi për ta rritur dhe forcuar atë, për momentin, është ngrirë. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen e të gjithëve që brengosen për fuqinë dhe vitalitetin e marrëdhënies.

Çfarë mesazhi po përpiqet të dërgojë ShBA-ja tek udhëheqësia e Kosovës me këtë hap?

Hovenieri: Nëse lexoni deklaratën e ShBA-së, atë të lëshuar nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë në kohën kur është bërë njoftimi, është e qartë se ky vendim është marrë nga autoritetet e Uashingtonit, si rezultat i perceptimit të tyre se qeveria e kryeministrit në detyrë [Albin] Kurti nuk po bashkëpunon mjaftueshëm. Ato konsiderojnë se, pavarësisht prej këshillave, sugjerimeve dhe përpjekjeve të ShBA-së, kryeministri dhe qeveria e tij në detyrë vazhdojnë të ndërmarrin veprime që, sipas Shteteve të Bashkuara, ndikojnë drejtpërdrejt dhe negativisht në sigurinë dhe stabilitetin në rajon.

Por, vini re se kjo pikëpamje nuk duket të jetë vetëm e Shteteve të Bashkuara. Partnerët evropianë, gjithashtu, kanë vazhduar të shprehin shqetësime të vërteta, lidhur me disa nga zgjedhjet politike të qeverisë së kryeministrit në detyrë, Kurti.

Nëse gjithçka do të ishte mirë, Dialogu Strategjik nuk do të pezullohej

A mund të jetë kjo pika më e ulët në marrëdhënie që nga pavarësia?

Hovenieri: Është e vështirë ta them, sepse edhe më herët ka pasur sfida të tjera në këtë marrëdhënie dypalëshe. Por, kjo nuk është një situatë e këndshme. Kjo është një pengesë e keqe për realizimin e vizionit që ShBA-ja ka pasur që nga pavarësia, dhe që populli i Kosovës ka pasur, po ashtu, për një bashkëpunim të përmirësuar dhe një partneritet më të fuqishëm.

Një gjë që kam vënë re në postimet në rrjetet sociale dhe deklaratat e tjera të zyrtarëve, është se disa po përpiqen ta minimizojnë këtë. Disa thonë se Albin Kurti dhe Qeveria e Kosovës ende kanë marrëdhënie të mira me ShBA-në, por kjo, thjesht, nuk është e vërtetë. Nëse gjithçka do të ishte mirë, nuk do

të kishte pasur nevojë për këtë vendim për të pezulluar Dialogun Strategjik - përkohësisht ose për një kohë të pacaktuar. Kjo tregon se administrata e Trumpit u frustrua aq shumë sa ndjeu se duhej të ndërmerre veprime, sepse deklaratat publike nuk mjaftonin për ta rikthyer marrëdhënien siç donte.

Pse Dialogu Strategjik është i rëndësishëm për Kosovën?

Hovenieri: Mendoj se është i rëndësishëm për Kosovën për shkak të mundësive që ofron. Siç e thashë më herët, temat që trajtohen në këtë dialog, janë: mbrojtja, siguria, siguria energjetike, tregtia, investimet, rritja ekonomike, siguria kibernetike dhe forcimi i lidhjeve mes njerëzve.

Gjatë tre vjetëve të mi si ambasador në Kosovë, këto ishin gjërat që populli i Kosovës dëshironte me të vërtetë t'i shihte - gjithnjë e më shumë. Dialogu Strategjik mundëson një bashkëpunim më të madh dhe më të thelluar. Funkcionon kështu: delegacionet shkojnë në Uashington, ose delegacionet vijnë në Prishtinë; Qeveria e ShBA-së sjell njerëz nga Departamenti i Energjisë, Departamenti i Mbrojtjes, Departamenti i Bujqësisë,

Departamenti i Tregtisë... Në njëfarë mënyre, e gjithë qeveria punon për të forcuar marrëdhënien. Ndaj, humbja e kësaj mundësie është një humbje e madhe.

Pika që e mbushi kupën

Disa argumentojnë se ky është rezultat i frustrimit të grumbulluar ndaj qeverisë së Kurtit. Jo shumë kohë më parë, kur keni qenë edhe ju në shërbim, kemi parë situata të ngjashme, siç e thatë më parë. Cila mendoni se është arsyeja për këtë vendim tani?

Hovenier: Qartazi, nuk flas në emër të administratës Trump, ndaj është e vështirë t'i shpjegoj saktësisht motivet dhe vendimet e saj. Do t'ju jap vlerësimin tim, i cili mund të jetë i gabuar. Nuk besoj se kishte një akt të vetëm që çoi në këtë vendim. Mendoj, gjithashtu, se ishte një grumbullim i frustrimeve, ose, për të përdorur një shprehje amerikane, ishte pika që e mbushi kupën. Mendoj se akti i fundit që çoi në këtë vendim - ai që bëri që njerëzit në Uashington të vendosnin se duhej të ndërmerrenin veprime - ishin deklaratat e kryeministrit dhe të tjerëve në Qeverinë e tij që kritikuan drejtpërdrejt Gjykatën Kushtetuese, një institucion i pavarur, i themeluar me Kushtetutë, në hartimin e së cilës ka kontribuuar edhe ShBA-ja. Nga këndvështrimi i çdo vëzhguesi, kjo dukej e papajtueshme me parimet e një demokracie të mirë, me mbrojtjen e pavarësisë së gjykatave dhe me respektimin e aftësisë së gjykatës për të marrë vendime.

Mendoj se kjo, ndoshta, ishte shkaku kryesor. Por, nuk ishte vetëm reagim ndaj kësaj. Ishte reagim pas një serie përpjekjesh nga zyrtarët amerikanë në këtë administratë, përfshirë një vizitë së fundmi të zyrtarit të lartë të Zyrës për Çështjet Evropiane, Brendan Hanrahan, në Prishtinë, ku ai u takua me presidentin [Vjosa] Osmani dhe kryeministrin [në detyrë] Kurti, për të diskutuar se si të përmirësohet marrëdhënia. Nuk isha aty, por mendoj se diskutimi lidhej me bashkëpunimin më të ngushtë me ShBA-në, për mënyrën se si Kosova do të trajtonte çështjet komplekse të mbështetjes për komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë. Qeveria amerikane ka përshtypjen se qeveria e kryeministrit në detyrë, Kurti, nuk po e dëgjon.

Përveç pezullimit të këtij dialogu, çfarë masash të tjera mund të marrë ShBA-ja për ta shtuar presionin mbi Kurtin?

Hovenier: Nuk e di përgjigjen për këtë. Sfidë me të cilën përballlet qeveria amerikane, ashtu siç

përballej edhe gjatë kohës sime, është se ka disa prioritetë që shpesh bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, ndërsa një prioritet kryesor mbetet shumë i rëndësishëm.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe populli amerikan e mbështesin Kosovën. Ne e mbështesim rrugëtimin e saj si një shtet evropian dhe euroatlantik, si një demokraci shumetnike, si një burim stabiliteti dhe sigurie në Evropën Juglindore, dhe jemi të përkushtuar të mbështesim popullin e Kosovës. Këtë e shihni në shumë mënyra: programet, aktivitetet, angazhimet, njerëzit...

Nëse shkoni në pothuajse çdo universitet në Kosovë, do të gjeni se amerikanët kanë ndihmuar në themelimin e tyre, kanë ndihmuar me programin e tyre mësimes, ose janë ende të pranishëm... Pra, Shtetet e Bashkuara duan të vazhdojnë të jenë një nga partnerët më të ngushtë - nëse jo partneri më i afërt - që ka Kosova.

Ne e dimë tmerrin e spastrimit etnik të viteve 1990 dhe jemi krenarë që e ndihmuam popullin e Kosovës të krijojë dhe të konsolidojë shtetin e tij. Administrata e [ish-presidentit amerikan, Joe] Biden dhe tani administrata e Trumpit kanë shqetësime të vërteta për disa veprime dhe vendime politike të Qeverisë së kryeministrit Kurti. Është kaq e thjeshtë. Kjo administratë ka arritur në të njëjtin përfundim si edhe administrata e mëparshme: mënyra më e mirë për të trajtuar çështjen delikate të mbështetjes së integritetit të mëtejshëm të Kosovës dhe sovranitetit të saj, është duke respektuar të drejtat dhe statusin e komuniteteve joshumicë, sidomos komunitetit serb, duke respektuar dispozitat kushtetuese, në mënyrë që ai komunitet të mund të jetojë në kushte dinjiteti dhe sigurie.

Siguria e Kosovës mbetet prioritet i ShBA-së

A ka mundësi që administrata aktuale e ShBA-së të vendosë kushte për bashkëpunim më të gjerë - për shembull në fushën e sigurisë ose ndihmës - nëse ndjen se po injorohet?

Hovenier: Nuk e di përgjigjen. Mund të them vetëm se është prioritet amerikan që Kosova të jetë e sigurt. Jemi krenarë që po ndihmojmë Forcën e Sigurisë së Kosovës të bëhet një forcë shumetnike, e aftë të punojë me NATO-n, dhe me misionin e mbrojtjes territoriale. Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e sigurisë dhe stabilitetit. Por, do të thosha se kjo administratë - pjesë e së cilës nuk jam - ka qenë më e gatshme për të ndërmarrë veprime që administratat e tjera nuk i kanë marrë. Prandaj, çdo qeveri e Kosovës duhet që sigurohet që të bashkëpunojë



ngushtë me ShBA-në.

Kam vënë re se presidentja [Vjosa] Osmani vazhdon të flasë shpesh për nevojën e koordinimit me Shtetet e Bashkuara... dhe - edhe kur nuk biem dakord si miq dhe partnerë - të ulemi së bashku dhe të gjejmë mënyra të përbashkëta për të ecur përpara. Kjo është shumë e rëndësishme.

Por, disa ndiejnë se vëmendja e ShBA-së tani nuk është aq shumë në Ballkan...

Hovenier: Mendoj se kjo është e vërtetë. ShBA-ja është një fuqi globale dhe mund t'i ndjekë zhvillimet dhe t'i mbrojë interesat e saj në të gjithë botën. Por, është e vërtetë se më parë, në vitet '90 dhe fillim të viteve 2000, çështja e Kosovës mernte vëmendje të drejtpërdrejtë nga presidenti, sekretari i Shtetit, këshilltari i Sigurisë Kombëtare dhe sekretari i Mbrojtjes. Tani nuk është më kështu, dhe kjo është diçka pozitive. Do të thotë se është bërë më e rregullt, më normale.

Ka ndoshta më shumë njerëz që merren me Kosovën dhe shqetësohen për çështjen e Kosovës sesa për, le të themi, Zvicrën ose Austrinë. Por, nga ana tjetër, ka shumë më tepër njerëz që u kushtojnë kohë shqetësimeve dhe hartimit të politikave amerikane për çështje si Izraeli-Palestina ose Ukraina. Ambasadat tona kanë njerëz të mirë dhe Qeveria amerikane ka ekspertë që i kushtojnë vëmendje Kosovës. Kosova mbetet një interes i ShBA-së. Jemi krenarë për ndihmën që i kemi dhënë popullit të Kosovës për të konsoliduar dhe krijuar shtetin e tij, dhe duam ta shohim Kosovën të suksesshme.

Suksesi ndërkombëtar i Kosovës varet nga partneriteti me ShBA-në

Në një situatë hipotetike, si do të dukej Kosova me më pak ndikim amerikan në praktikë? A mund të navigojë Kosova pa mbështetje të fortë amerikane?

Hovenier: Ky është një vendim që i takon vetëm popullit të Kosovës, jo ShBA-së. ShBA-ja do të vazhdojë të ofrojë miqësi dhe partneritet, por vendimin e fundit duhet ta marrë Kosova. Nëse do të isha udhëheqës politik i Kosovës - që nuk jam - do të isha shumë i kujdesshëm për të mos bërë asgjë që do të dëmtonte ose do të ndikonte negativisht në marrëdhënien time me Shtetet e Bashkuara. Pothuajse të gjitha sukseset që ka arritur Kosova në arenën ndërkombëtare, kanë përfshirë mbështetjen aktive nga Shtetet e Bashkuara.

Atëherë, nëse ky pezullim i Dialogut Strategjik vazhdon, me çfarë rreziku përballlet Kosova, veçanërisht duke pasur parasysh lidhjet në rritje të Serbisë me Rusinë dhe Kinën?

Hovenier: Siç thashë, Dialogu Strategjik është vetëm një nga shumë mjetet. [Pezullimi i tij] përfaqëson thjesht një mundësi të humbur. Nuk përfaqëson më shumë se kaq, por është një humbje reale e mundësisë. Disa vende në rajon kanë Dialog Strategjik me Shtetet e Bashkuara, disa nuk kanë, por mendoj se partneriteti dhe bashkëpunimi do të forcoheshin përmes Dialogut Strategjik. Pra, efekti për Kosovën është humbja e mundësive dhe bashkëpunimit. Vendet që punojnë më ngushtë me ShBA-

në, kanë më shumë gjasa të përfitojnë nga bashkëpunimi më i madh.

Çfarë mesazhi dërgon ky vendim te partnerët e BE-së dhe NATO-s për prioritetet e ShBA-së në Ballkan dhe veçanërisht në Kosovë?

Hovenier: Nuk mendoj se do të përfundojnë duke thënë se Kosova nuk është prioritet. Por, do të kuptojnë se ShBA-ja po tregon shqetësim më të madh për mungesën e bashkëpunimit të mirë dhe partneritetit që dëshiron nga Kosova. Shumë prej tyre ndajnë këtë pikëpamje. Shumë prej tyre, gjithashtu, kanë ndërmarrë veprime në mënyra të ndryshme. Gjatë kohës sime në Kosovë, flisnim për sanksionet e BE-së, që gjithashtu sinjalizonin shqetësim.

ShBA-ja mbetet partnere e popullit të Kosovës

Duke pasur parasysh rolin e Amerikës në ndërtimin e shtetit të Kosovës, çfarë do t'u thoshit kosovarëve të zakonshëm që mund të ndihen të shqetësuar për këtë vendim?

Hovenier: Do t'u thosha këtë: Shtetet e Bashkuara nuk kanë ndërmend të braktisin partneritetin me popullin e Kosovës. Por, ne bëjmë dallimin midis përkushtimit tonë ndaj Kosovës - shtetit, popullit dhe institucioneve - dhe çdo qeverie të veçantë. Dhe, është e qartë se administrata e Trumpit ka shqetësime për cilësinë e partneritetit me qeverinë e kryeministrit në detyrë, Kurti.

Dhe, çfarë do t'u këshillonit udhëheqësve të Kosovës tani, nëse duan ta rikthejnë besimin tek Uashingtoni?

Hovenier: Unë nuk kam qenë së voni pjesë e bisedimeve me kryeministrin, ministrat e tij dhe homologët amerikanë, kështu që nuk e di saktësisht se çfarë po rekomandon Qeveria e ShBA-së tani. Gjatë kohës sime, ajo që kërkonim ishte bashkëpunim më i ngushtë mbi mekanizmin e vështirë të shfuqizimit të mbështetjes së shtetit serb për komunitetin serb në Kosovë, si dhe të mos ndërmerren veprime të nxituara ose të njëanshme, si mbyllja e klinikave shëndetësore, zyrrave të sigurimeve shoqërore apo gjërave të tjera të ngjashme. Ne pajtoheshim që ato duhej të integroheshin në strukturat e shtetit të Kosovës, por një gjë e tillë duhej të bëhej në një mënyrë të dakorduar përmes dialogut [për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë]. [I dërguari i BE-së] Peter Sorensen është një negociator shumë i aftë. Gjetja e një rruge përpara, që të jetë e pranueshme për të dyja palët, besoj se vazhdon të jetë ajo që kërkon kjo administratë. Por, siç e thashë, unë nuk kam qenë pjesë e këtyre bisedimeve që nga fundi i dhjetorit.

BESIMI I BREZIT TONË NË LUFTËN E UÇK-së DHE KRITIKA E HAPUR PËR PROJEKTIN E ROBËRISË SË RE TË CHRISTOPHER HILLIT

“Për idealin e Fehmiut, Xhevës dhe trimave të tjerë të lirisë, që ranë në mbrojtje të atdheut, duhet të luftojmë të gjithë. Edhe udhëheqësit tanë duhet të bashkohen dhe t’i bashkërendojnë veprimet me UÇK-në, me qëllim të arritjes së pavarësisë së Kosovës. Vetëm atëherë bashkësia ndërkombëtare do të shohë se shqiptarët njëmend janë të vendosur në luftën e tyre për çlirimin definitiv të Kosovës. Dhe atëherë Perëndimi nuk do të ofrojë projekte nënshtruese për shqiptarët, siç ishte ai i ndërmjetësuesit amerikan për Kosovën, Christopher Hillit” - pata shkruar në nëntor 1998 në një kohë vendimtare për Kosovën. E risjellë në kujtesë këtë shkrim i motivuar nga dëshmia e ndihmës nënsekretarit amerikan të Shtetit gjatë kohës së luftës së Kosovës, James Rubin, i cili e dëshmoi rolin e njëanshëm të Hillit gjatës angazhimit të tij në Kosovë



Shkruan: Arianit BYTYÇI

Dëshmia e ndihmës nënsekretarit amerikan të Shtetit gjatë kohës së luftës së Kosovës, James Rubin në procesin gjyqësor ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë, tek brezi ynë që e përjetoi dhe e mbështeti në kohë reale luftën çlirimtare nga bankat shkollore të kryeqytetit të Kosovës, zgjoi emocione dhe kujtime nga ajo kohë vendimtare për lirinë e Kosovës.

Në një nga paraqitjet në kuadër të dëshmisë së tij të fuqishme në Hagë, James Rubin përmend edhe faktin se ish-ndërmjetësi amerikan në negociatat mes Prishtinës dhe Beogradit gjatë viteve 1998-1999, Christopher Hill, i cili deri para pak kohësh “rastësisht” shërbente si ambasador i SHBA-ve në Beograd, gjatë asaj periudhe mbante qëndrim të njëanshëm kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pro Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke vazhduar ta përçante skenën politike shqiptare dhe duke sabotuar edhe më shumë krijimin e një fronti të përbashkët ushtarako-politik shqiptar në Kosovë, për krijimin e të cilit UÇK kishte emëruar simbolin e rezistencës shqiptare, Adem Demaçin.

Në këtë mënyrë, siç e konfirmoi James Rubin edhe në dëshminë e tij, Christopher Hill duke dëmtuar interesat e SHBA-ve për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për Kosovën, asokohe para palës shqiptare kishte prezantuar një plan jo të favorshëm për Kosovën, që parashihje që Kosova të vazhdonte të mbetej në kuadër të Serbisë. Natyrisht, ky plan ishte refuzuar nga UÇK, duke inkurajuar kështu një angazhim më serioz të administratës së presidentit Clinton në muajt në vazhdim gjatë viteve 1998 dhe 1999, që rezultoi me bombardimet e NATO-s dhe me largimin e forcave ushtarako-

policore dhe administratës serbe nga Kosova.

Gjatë asaj kohe, pra gjatë vitit 1998 dhe në vazhdimësi, bashkë me shumë shokë dhe shoqe, nxënës të gjimnazit “Xhevdet Doda” të Prishtinës, kishim shprehur në mënyrë publike mbështetjen tonë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Këtë e bënim përmes organizatës së Rinisë Shkollore të shkolllës, duke organizuar tryeza në me intelektualë, liderë studentorë dhe publicistë të njohur, si dhe përmes botimit të shkrimeve në mbështetje të orientimit politiko-ushtarak të UÇK-së në revistën tonë “Gjimnazisti” dhe në gazetën e studentëve “Bota e Re”. Në tryeza dilnin hapur, siç edhe shkrimet i botonim me emër dhe mbiemër, pa asnjë dilemë për të fshehur identitetin tonë.

“Bota duhet ta kuptojë se Kosova nën Serbi, nuk është dhe nuk mund të jetë zgjidhje....”

I motivuar nga dëshmia e mikut të kohëve të vështira të Kosovës, diplomatit amerikan James Rubin, po risjell disa nga citatat e këtyre shkrimeve ku qysh në nëntor 1998 në shkrimin “Vetëm me sakrifica mund të çlirohemi nga zgjedha serbe”, në një kohë kur udhëheqja politike e Kosovës në Prishtinë ishte e përçarë dhe nuk dërgonte sinjale në mbështetje të UÇK-së, përderisa bashkësia ndërkombëtare, e përfaqësuar nga negociatori Hill dhe të tjerët i mbyllte sytë para ofensivës serbe dhe tentonte të ofronte zgjidhje për Kosovën në kuadër të Serbisë:

“Kosova në momentin e tanishëm gjendet në një udhëkryq të madh. Derisa trimat e lirisë përballen me ofensivë shkatërrimtare serbe, udhëheqësit politikë të Kosovës mbeten të përçarë, duke mos ditur se lufta një dite mund ta përfshijë edhe çdo pëllëmbë të Kosovës. Ata dalin me deklarata të papërgjegjshme para faktorit ndërkombëtar duke mohuar ndikimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Këtë mosunitet të subjektit politik të Kosovës e shfrytëzon edhe pushteti terrorist serb, i cili ndërmori ofensive të madhe kundër popullit të

Kosovës, por e shfrytëzoi edhe bashkësia ndërkombëtare, e cila sikur i dha dritën e gjelbër Beogradit për të ndërmarrë ofensivën e shkatërrimit të UÇK-së dhe nënshtrimin të shqiptarëve, në mënyrë që ata të pranojnë një zgjidhje kinse të përkohshme, e në fakt ajo mund të jetë e përhershme - një robëri e re”.

Pikërisht në vazhdim të këtij shkrimi, me besim të madh se vetëm vazhdimi i luftës mund të na çlirojë nga Serbia pata shtuar: “Serbia duhet ta ketë të qartë se ofensiva kundër UÇK-së ka dështuar. Serbia ndoshta i ka marrë nën kontroll të përkohshëm disa territore, por UÇK-në nuk e ka shkatërruar dhe nuk mund ta shkatërronjë kurrë. UÇK është vetë populli.

Lufta çlirimtare e trimave të lirisë po hyn në një fazë të rëndësishme dhe duhet të kuptojmë një herë e përgjithmonë se vetëm vazhdimi i saj dhe një politikë më aktive, mund të na çlirojë nga Serbia”.

Në shkrimin ku shkruaja edhe për rënien e komandantit të njohur Fehmi Lladrovci dhe bashkëshortes së tij Xhevë Krasniqi-Lladrovci, duke bërë thirrje për bashkimin e udhëheqësve politikë të Kosovës për bashkërendim të veprimeve me UÇK-në, potenciaja se:

“Për idealin e Fehmiut, Xhevës dhe trimave të tjerë të lirisë, që ranë në mbrojtje të atdheut, duhet të luftojmë të gjithë. Edhe udhëheqësit tanë duhet të bashkohen dhe t’i bashkërendojnë veprimet me UÇK-në, me qëllim të arritjes së

pavarësisë së Kosovës. Vetëm atëherë bashkësia ndërkombëtare, do të shohë se shqiptarët njëmend janë të vendosur në luftën e tyre për çlirimin definitiv të Kosovës. Dhe, atëherë perëndimi nuk do të ofrojë projekte nënshtruese për shqiptarët, siç ishte ai i ndërmjetësuesit amerikan për Kosovën Christopher Hill-it”.

I shtyrë nga propozimi skandaloz i Hill-it, që asokohe ishte botuar edhe në shtypin e përditshëm shqiptar, përkatësisht në “Koha Ditore”, në këtë shkrim timin të botuar në nëntor të vitit 1998 pata vënë theksin se: “Bota duhet ta kuptojë se Kosova nën Serbi, nuk është dhe nuk mund të jetë zgjidhje. Çdo popull ka të drejtë të vendosë vet për fatin e tij, pra edhe populli i Kosovës. Kjo parashihet edhe me kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Po ashtu edhe Serbia duhet ta ketë të qartë se kurrë nuk mund ta mbajë Kosovën” përfundon ky shkrim.

“Populli nuk pranon robërinë e re”

Në të njëjtin numër të “Gjimnazistit” në fundvitin 1998 bashkë me shokun e klasës Fiton Pejën, të shtyrë po ashtu nga propozimi i Hill-it patëm shkruar një shkrim të përbashkët me titullin “Populli nuk pranon robërinë e re”, ku mes tjerash patëm shkruar: “Pas gjithë kësaj lufte, e cila po vazhdon, pas gjithë këtyre masakrave, Perëndimi shqiptarëve u ofron një “zgjidhje” joserioze, një robëri të re. Këtë e dëshmojnë më së miri projektet amerikane për Kosovën, ai i Hillit dhe i Hollbrukut”.

Është më rëndësi të potencojmë se ne si nxënës gjatë periudhës së luftës çlirimtare ishim thellësisht të bindur se “pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në negociata, nuk mund të arrihet kurrëfarë

marrëveshje për statusin e ardhshëm të Kosovës. Edhe bota më në fund duhet ta kuptojë se pas agresionit serb në Kosovë, pavarësia e Kosovës është zgjidhja më e drejtë dhe më e qëndrueshme e problemit të Kosovës”.

Në këtë aspekt, koha na dha të drejtë. Bota demokratike në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës reflektoi pozitivisht në mbështetje të Kosovës dhe luftës sonë çlirimtare, duke u fokusuar te roli thelbësor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në arritjen e një marrëveshje të qëndrueshme për të arritur të arritur çlirimin e Kosovës.

Ky besim yni si brez i maturantëve prishtinas të viteve 1998-1999 që SHBA duhet të lirohet nga propozimet skandaloze të tipit të Christopher Hill-it dhe të marrë rol më determinues në mbështetje të lirisë së Kosovës u konfirmua në mënyrën më të mirë të mundshme nga James Rubin në Hagë kur mes tjerash tha: “Ne dëshironim të siguroheshim që të ishim në anën e engjëjve, në anën e të mirëve. Dhe nuk donim që ata të ishin viktimat. Por s’mund të ishin viktimat nëse do të kryenin krime lufte, e as nuk do të ishin viktimat nëse do të kishin qasje ekstremiste islamiste”.

Prandaj, ashtu si në vitin 1998, edhe sot, e them me bindje e besim se Kosova u mbështet nga SHBA-të në rrugën e saj për çlirim dhe shtetformim vetëm pse zhvilloi luftë të drejtë me orientim të qartë të promovimit të vlerave demokratike të civilizimit perëndimor edhe në këtë pjesë të Evropës. Kjo histori e lirisë së Kosovës nuk mund të rishkruhet.

P.s.: Bashkëngjitur me këtë shkrim autorial, në vazhdim po ua prezantoj dy shkrimet e vitit 1998 të botuara në mbështetje të UÇK-së dhe duke kritikuar me argumente propozimin e Christopher Hillit për një zgjidhje të çështjes së Kosovës në kuadër të Serbisë



KCSF: KONSULTIMI PUBLIK NË KOSOVË VETËM PROCEDURAL DHE PA PËRFSHIRJE DOMETHËNËSE TË PUBLIKUT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ka publikuar gjetjet kryesore nga monitorimi i konsultimit publik në nivel qendror për vitin 2024, duke vlerësuar se konsultimi publik në Kosovë mbeti kryesisht procedural dhe nuk arriti të sigurojë përfshirje domethënëse të publikut.

Edhe pse rreth 80 % e legjislacionit dhe politikave të miratuara gjatë vitit 2024 janë publikuar paraprakisht për konsultim në Platformën Online për Konsultim Publik, procesi dështoi të mundësojë: 1) përfshirje të hershme të publikut; 2) pjesëmarrje përmes formave të ndryshme të konsultimit; dhe 3) trajtim dhe adresim të plotë të kontributeve të publikut.

Gjatë vitit 2024 KCSF-ja ka monitoruar 261 procese të



konsultimit publik në nivel qendror të publikuara për konsultim, përfshirë udhëzime administrative, rregullore, projektligje, koncept dokumente, strategji dhe dokumente të tjera. Gjetjet kryesore nga ky monitorim theksojnë se pati mungesë të përfshirjes së hershme të publikut. Asnjë takim fillestar me publikun nuk

u mbajt para fillimit të hartimit të draftpolitikave, duke ua pamundësuar qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të ndikojnë në fazat e para të politikbërjes. Dominim i një kanali të vetëm: Platforma Online mbeti pothuajse i vetmi kanal për pjesëmarrje në procesin e konsultimit publik. Në të njëjtën kohë platforma

pati probleme të konsiderueshme teknike, duke mos qenë funksionale për një periudhë të caktuar të vitit, gjë që pamundësoi pjesëmarrjen e publikut në proces. Publiku nuk u informua se çka ndodhi me kontributin e tij: Për gjysmën e politikave të komentuar, institucionet dështuan të publikojnë informata mbi

trajtimin dhe adresimin e komenteve të publikut. Vetëm 53.5 % e raporteve përfundimtare të konsultimit u publikuan në Platformën Online, shpesh me vonesa të mëdha. Shoqëria civile, kontribuuesja më aktive: OShC-të kontribuuan me pothuajse gjysmën e komenteve në Platformën Online, duke treguar interesim të vazhdueshëm për të ndikuar në politikbërje.

Në përgjithësi gjetjet nga monitorimi tregojnë se edhe pse ekziston një bazë ligjore dhe një platformë për konsultim publik, në praktikë procesi shpesh mbetet formal dhe jogjithëpërfshirës. Përmirësimi i konsultimit publik kërkon adresim si të problemeve teknike ashtu edhe të atyre përmbajtësore, transparencë më të madhe, mekanizma të larmishëm për pjesëmarrje dhe respektim të standardeve minimale ligjore.

BISLIMI E MOHON SE KOSOVA PO I SHËNJESTRON INSTITUCIONET SHËNDETËSORE SERBE NË VERI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Zëvendëskryeministri në detyrë i Kosovës, Besnik Bislimi, e ka mohuar të martën se autoritetet e Kosovës janë duke i shënjestruar institucionet shëndetësore, të udhëhequra nga Serbia, në veri të vendit, i cili është i banuar me shumicë serbe.

Në një reagim në llogarinë e vet personale në "X", Bislimi tha se Kosova "nuk po shënjestron madje as ato të jashtëligjshme të krijuara nga Serbia [askush nuk e kupton kuptimin ligjor të termit të përdorur zakonisht 'institucione të drejtuara nga Serbia në Kosovë']".

Reagimi i Bislimit vjen pas kritikave nga bashkësia ndërkombëtare për pezullimin e punës së Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Fondit për Sigurim Invalidor e Pensional, që punojnë sipas sistemit të Serbisë,

në Mitrovicën e Veriut më 12 shtator.

Në veçanti Gjermania i bëri thirrje "urgjente" Kosovës të përmbahet nga "shënjestrimi" i institucioneve shëndetësore të drejtuara nga Serbia në territorin kosovar, pasi paraprakisht Bashkimi Evropian kërkoj nga qeveria në detyrë dhe institucioneve të tjera relevante "të përmbahen nga provokime të tilla dhe veprime të dëmshme si dhe të konsultohen me komunitetin lokalë serbë dhe partnerët ndërkombëtarë".

Serbia e cilësoi pezullimin e punës së fondit si "akt të papranueshëm dhe çnjerëzor". Por, Bislimi - i cili është kryenegociator i Kosovës në dialogun me Serbinë në Bruksel - nguli këmbë të martën se Kosova po punon për një zgjidhje për përfshirjen e tyre në kuadrin tonë ligjor, "duke siguruar që të mos



ketë ndërprerje në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të ketë akomodimin maksimal të stafit shëndetësor". "Inspektorët lokalë të tregtisë kanë mbyllur për kohësisht veprimtarinë e një fondi, i cili lëshonte jashtëligjshëm kuponë dhe kryente transaksione, deri në dorëzimin e provave përkatëse",

tha Bislimi.

Bislimi e akuzoi Serbinë për "manipulimin e opinionit publik me prodhim masiv të lajmeve të rreme".

Fondi për Sigurime Shëndetësore në Mitrovicën e Veriut funksionon në kuadër të Fondit Republikan për Sigurime Shëndetësore të Serbisë dhe

ofron shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor - si vërtetimin e librezave shëndetësore, punët që lidhen me komisionet mjekësore, bën llogaritjen, kontrollin dhe pagesën e kompensimeve financiare, si dhe vërtetimin e kërkesave për ndihma mjekësore-teknike dhe të ngjashme.

Në mjediset serbe në Kosovë të gjitha institucionet shëndetësore dhe arsimore funksionojnë sipas sistemit të Serbisë.

Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë" në shtator të vitit 2024, ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se funksionimi i shëndetësisë dhe arsimit në mjediset me shumicë serbe është specifik dhe se këto institucione do të trajtohen në mënyrë specifike, ndaras nga mbyllja e institucioneve të tjera serbe.

Ismaili për Dardaninë: Dy parkingje nëntokësore dhe buxhet 14 milionë i ndarë vetëm për lagjen

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka vazhduar prezantimin e zgjidhjeve specifike për lagjet e kryeqytetit, ku pas Kodrës së Trimave, të mërkurën vazhdoi me Dardaninë - një nga lagjet më të rëndësishme të Prishtinës. Ismaili u zotua se kjo lagje do të marrë më shumë vëmendje dhe investime konkrete, duke thënë se "Dardania ka nevojë për jetë

më të mirë në lagje, jo për hapësira pa gjallëri e pa mirëmbajtje".

Projektet identifikuese të Urani Ismailit për Dardaninë përfshijnë: Rivitalizimin e plotë të Kurrizit dhe hapësirës rreth Santesë; Rinovimin e të gjitha ndërtesave me fasada të reja, izolim dhe panele solare; Riparimin e të gjithë ashensorëve ekzistues në lagje; Ndërtimin e dy parkingjeve nëntokësore për t'i liru

hapësirat publike para ndërtesave; Krijimin e një qendre multifunksionale të lagjes me pishinë gjysmolimpike dhe hapësira rekreative.

Ismaili theksoi se këto projekte do ta kthejnë Dardaninë në një lagje më funksionale, me hapësira moderne dhe të mirëmbajtura, ku qytetarët do të ndihen pjesë e një jete urbane më të gjallë dhe cilësore.



Mbahet trajnimi i regjistruesve dhe mbikëqyrësve për anketën e ICT 2025

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka njoftuar se gjatë kësaj jave po zhvillohet trajnimi i regjistruesve dhe mbikëqyrësve për anketën e ICT 2025. Në këtë trajnim pjesëmarrësit po njihen me aplikacionin CAPI - mjetin modern për mbledhjen digjitale të të dhënave në terren; Përmbajtjen e pyetësorit - përfshirë edhe modulën e

Anketës së Përdorimit të Kohës (Time-Use Survey); Sistemin qendror të ASK-së - i cili mundëson monitorim në kohë reale të çdo aktiviteti në terren, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. ASK-ja ka njoftuar se i kushton rëndësi të veçantë kësaj ankete, pasi rezultatet e viteve të kaluara treguan se Kosova

ka një nga normat më të larta të qasjes në ICT në Evropë - një arritje që e pozicionon vendin si shembull pozitiv dhe motivon ASK-në të vazhdojë me përkushtim për sigurimin e të dhënave cilësore. ASK-ja ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit dhe stafin që po kontribuojnë në suksesin e këtij projekti.



BQK-ja FORCON KAPACITETET INSTITUCIONALE DREJT INTEGRIMIT NË SISTEMIN E BANKAVE QENDRORE EVROPIANE

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka marrë pjesë në ceremoninë e përfundimi me sukses të Fazës së Dytë të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor, që ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe standardeve drejt integritimit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (ESCB). Pjesëmarrësve në ceremoninë e përmbylljes që u mbajt në Frankfurt të Gjermanisë, iu drejtua me një fjalë rasti anëtar i Bordit Ekzekutiv të Deutsche Bundesbank, Burkhard Balz. Gjatë 36 muajve të programit të realizuar nga Deutsche Bundesbank në partneritet me

bankat qendrore të Belgjikës, Bullgarisë, Çekisë, Greqisë, Spanjës, Francës, Kroacisë, Irlandës, Italisë, Lituaniës, Luksemburgut, Hungarisë, Holandës, Austrisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovenisë dhe Sllovakisë, si dhe me kontributin e Bankës Qendrore Evropiane, BQK-ja ka qenë pjesë aktive e një sërë aktiviteteve që kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të saj. Në kuadër të programit u zhvilluan 20 trajnime të specializuara dhe katër punëtori të politikave në nivel të lartë, ku BQK-ja mori pjesë krahas bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse të rajonit. Përveç këtyre, BQK-ja



përfitoi nga 9 aktivitete bilaterale, të realizuara me bankat qendrore të Austrisë, Luksemburgut, Italisë, Lituaniës, Sllovenisë dhe Holandës, si dhe me Autoritetin kroat të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare.

Fushat kryesore të mbështetjes përfshinin qeverisjen, menaxhimin e rrezikut, qëndrueshmërinë operacionale, mbikëqyrjen bankare, luftën kundër pastrimit të parave, stabilitetin financiar, sistemet e pagesave, statistikën dhe

digjitalizimin. Përmes këtyre aktiviteteve BQK-ja jo vetëm që ka përforcuar kapacitetet e saj të brendshme, por ka avancuar ndjeshëm në adoptimin e standardeve, duke përparuar në rrugën drejt integritetit evropian dhe duke nxitur komunikimin e bashkëpunimin rajonal. BQK-ja shpreh mirënjohjen e saj për Bashkimin Evropian për financimin e programit në kuadër të Instrumentit të Asistencës Para-Anëtarësimit (IPA III), Deutsche Bundesbank për menaxhimin dhe koordinimin e tij, si dhe për Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore pjesëmarrëse të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore për kontributin e dhënë në realizimin me sukses të programit.

LANSOHET SKEMA E GRANTEVE PËR NDËRMARRJET PRODHUESE

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Në ndërtesën e qeverisë u lansua skema e granteve për ndërmarrjet prodhuese. Ky grant përkrahët nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes Agjencisë së Zhvillimit të Luksemburgut, LuxDev, në vlerë totale prej një milion euro. Nga kjo skemë mund të përfitojnë të gjitha ndërmarrjet prodhuese mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe ato të mëdha të cilat nuk përfitojnë nga tarifat e rregulluara të energjisë elektrike. Të pranishëm në ngjarje ishin kryeministri në detyrë Albin



Kurti, bashkë me ministren në detyrë të Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministren në detyrë të Industrisë, Ndërmarrësisë

dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz. “Kjo përkrahje që ua japim

ndërmarrjeve, vjen si vazhdimësi e katër viteve të punës për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe ekonomisë të vendit tonë”, tha Kurti në fillim të fjalës së tij. Ai shtoi se kjo skemë që po paraqitet sot është reflektim i dy prioritetëve të qeverisë sonë: përkrahjes për sektorin privat dhe rritjes së eficiencës së energjisë. Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se kjo iniciativë bazohet edhe në dy shtyllat kryesore të strategjisë sonë për energji: investimet në eficiencën e energjisë për ta ulur konsumin dhe investimet në gjerimin e energjisë së pastër.

Ndërkaq, Rozeta Hajdari, ministre në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, tha se në këtë skemë do të kenë fokus ndërmarrjet më të prekura nga tregu i hapur i energjisë elektrike, projektet e të cilëve synojnë ta rritin eficiencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme brenda ndërmarrjeve. Ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, u shpreh se me këtë skemë po shënohet një hap për zotimin afatgjatë të Luksemburgut në fuqizimin e sektorit privat dhe përkrahjen ndaj rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Më pak thëngjill i prodhuar në korrik 2025 sesa në korrik 2024

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Statistikat e energjisë” për muajin korrik 2025 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Gjatë muajit korrik 2025 energjia

elektrike bruto në dispozicion ishte 508.65 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 334.56 GWh ose 16,87 % më i vogël krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 9,94 %. Importi i energjisë elektrike në

korrik 2025 ishte 337.64 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 244.16 GWh (këtu është përfshirë edhe sasia e transmisionit). Prodhimi i thëngjillit për muajin korrik 2025 ishte rreth 380.48 mijë tonë që paraqet një rënie prej (-39,77 %) në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.



TRUMP NË BRITANINË E MADHE - DIPLOMACI DHE NERVOZITET



Presidenti i SHBA-së Donald Trump të martën në mbrëmje (16.09.2025) mbërriti për një vizitë shtetërore në Britaninë e Madhe. Në program: Bisedime me mbretin Charles III dhe kryeministrin Starmer.

Avioni presidencial Air Force One aderoi në orën 21:07 sipas orës lokale në afërsi të Londrës. Presidenti i SHBA-së Donald Trump të mërkurën do të pritët në kështjellën Windsor nga mbreti Charles III. Të enjten (18.09.2025) Trump do të takohet me kryeministrin britanik Keir Starmer në çiflikun e tij Chequers.

Kur kryeministri britanik Keir Starmer në fund të shkurtit 2025 i dorëzoi presidentit Trump në Oval Office ftesën e nënshkruar nga mbreti Charles, pasoi një skenë teatri politik, që ka shanse të mira për të hyrë në historinë britanike: "A ta lexoj tani?", pyeti Trump. "Po, të lutem", u përgjigj Starmer dhe shtoi më pas: "Tani mungon vetëm përgjigja juaj." Trump menjëherë ia ktheu: "Përgjigja ime është: po." Të paktën për këtë çast raportet ndërmjet dy vendeve u shpëtuan. Kur Trump shpalli tarifat për doganat ndërkombëtare Britania e Madhe me dhjetë përqind doli më e favorizuar krahasuar me vende të tjera.

Letrën e mbretit Charles Trump e mbajti aq të hapur para kamerave, sa mund të deshifroheshin lehtësisht fjalët e mbretit. Në Britaninë e Madhe kjo u prit nga njëra anë me kureshtje, por edhe me pak indinjatë. "Që zarfi me një ftesë për një vizitë shtetërore u dorëzua personalisht, kjo ndodh për herë të parë", thotë

historiani dhe ekspert i shtëpisë mbretërore Robert Lacey. Vetëm ky gjest, sipas tij, tregon se sa politike është kjo vizitë.

Për Donald Trump kjo është vizita e dytë shtetërore si president. Herën e parë gjatë mandatit të tij të parë ai u prit më 2019 nga mbretëresha Elisabeth II në Londër.

Pushteti i butë mbretëror mund të ketë efekt tek Trump

Asnjë drejtues tjetër shteti Mbretëria e Bashkuar nuk e ka nderuar me një ftesë të dytë për vizitë shtetërore. Ky është një rekord tërësisht sipas shijes së Trumpit. "Pa shpresën për të ardhur në Windsor, të takojë mbretin dhe të përkujtojë mbretëreshën me një vizitë tek varri i Elisabeth II, Trump nuk do të kishte ardhur", mendon Lacey. Vizitat shtetërore në Mbretërinë e Bashkuar janë nderi më i madh diplomatik për kryetarë shtetesh dhe qeverish, por ato shërbejnë edhe si një armë e fshehtë diplomatike për pushtetin e butë të monarkisë. Kjo mund të ketë efekt të veçantë tek presidenti i SHBA-së. "Trump ka admirim për aristokracinë me taban të fortë si dhe pasurinë e saj. Ai vet është mishërimi i pasanikut të ri e për këtë arsye ka edhe një farë kompleksi inferioriteti", thotë politologu i specializuar për marrëdhëniet SHBA-Britani e Madhe, Mark Shanahan nga Universiteti anglez Surrey: "Me të gjitha lidhjet e tij në shtëpitë mbretërore dhe familjet fisnike të Europës Charles është një lloj diplomati dhe kjo do t'i lerë

përshtypje e do ta influencojë Trumpin."

Të shtëna me top, banquet dhe përgatitje enkas

Për dy ditë (17.09 -18.09) presidenti i SHBA-së do të jetë në Britaninë e Madhe i shoqëruar nga bashkëshortja Melania. Janë planifikuar një udhëtim me pajton, të shtëna nderi me top. Një banquet pompoz shtetëror me rreth 160 të ftuar dhe mbrëmjen e së mërkurës Trump do ta kalojë në kështjellën Windsor. Të enjten janë në plan takimi me kryeministrin Starmer: Në program janë kryesisht tema ekonomike dhe politike, ndër to intelijenca artificiale, investimet, doganat si dhe Gaza e Ukraina. Se çfarë do të arrijë qeveria e Starmerit, këtë e ka mjaft mirë parasysh mbreti Charles. Kryeministri dhe mbreti takohen gjithësesi një herë në javë në audiencë private, dhe përpara vizitave të tilla shtetërore kontakti ndërmjet pallatit mbretëror dhe Downing Street 10 intensifikohet.

"Mbreti përgatitet në mënyrë të detajuar nga qeveria, për atë se për çfarë duhet të flasë apo të mos flasë tani me Trump", thotë politologu Shanahan. Edhe princesha Catherine, e quajtur Kate, princesa e Uellsit, luan një rol të rëndësishëm. "Princesha po ashtu përgatitet enkas për bisedimet me Melania Trump, sepse besohet, që First Lady ka influencë të madhe tek burri i saj. "Pjesëtarët e familjes mbretërore në bisedimet e tyre me Trump do të plasojnë tek

Trump informacionet e duhura duke shprehur që ato ashtu si fara të bien në tokë pjellore", thotë Shanahan.

Simbolikisht e rëndësishme

Vizita shtetërore e presidentit Trump është për mbretin Charles një tjetër pikë kulmore në këtë vit me aktivitet intensiv diplomatik për të. Fillimisht shumë britanikë druanin, se Charles, pikëpamjet politike të të cilit njihen shumë më tepër se sa ato të nënës së tij, që ai si mbret do të fokusohet shumë më fort tek politika e ditës brenda vendit. Por tani qeveria gjithnjë e më shumë po kërkon prej tij që të jetë aktive në një mënyrë krejt të veçantë. Charles, i cili vazhdimisht është shprehur solidar për Ukrainën, në fillim të marsit me kërkesën e qeverisë britanike priti Volodymyr Zelenskyjn – pak pasi presidenti ukrainas u konfrontua në Oval Office me qendrimin e ashpër të Trumpit dhe zëvendës-presidentit JD Vance. Në fund të majit Charles udhëtoi në Kanada, ku si kreu i shtetit hapi parlamentin kanadez. Në fjalimin e tij ai theksoi sovranitetin kanadez. "Vizita në Kanada pasi Trump u shpreh për një shtet të 51-të të SHBA-së, ishte mjaft simbolike. Pallati do të thoshte jo politike, por me rëndësi simbolike", nënvizon ish-diplomatik britanik Nicolas Westcott.

Nervozitet i madh

Jo vetëm lidhur me Ukrainën ose Kanadanë, por edhe për temat si

klima dhe mbrojtja e mjedisit apo vaksinimi, pikëpamjet e Trump dhe Charles kanë dallime të mëdha. Për shkak të këtyre qendrimeve dhe reagimit të paparashikueshëm të Trumpit në politikën botërore, si në komportimin e tij ndaj kreut të Kremlinit Vladimir Putin dhe faktit që britanikët relativisht nuk e preferojnë Trumpin, vazhdimisht në mediet britanike është speculuar, se pallati mbretëror e ka pranuar me sforc vizitën dhe se do të kishte preferuar ta shtynte atë. Downing Street 10 në të kundërt ka insistuar për këtë periudhë. Rezultati është tani një vizitë mjaft kompakte, jashtë Londrës, me pak pika kontakti me opinionin publik britanik.

Ish-diplomati Westcott thotë: "Mbreti e kupton ashtu si edhe nëna e tij. Është detyrim i monarkut, që të mbështesë vendin dhe qeverinë. Nëse diçka është e rëndësishme për vendin, kjo është e rëndësishme edhe për mornarkun. Një raport i mirë me presidentin e SHBA-së është e pjesë e rëndësishme e kësaj, pavarësisht nga pikëpamjet personale apo politike të tij." Nervoziteti në pallat dhe në qeverinë britanike është i madh. "Sado perfekt të jenë organizaur të gjitha, ndonjëherë mjafton vetëm një çast, një imazh që mund të kthehet në temën e vetme", thotë Westcott. Protestat e planifikuara dhe një president kryeneç, që rrallëherë i përmbahet manuskriptit, janë potencial i mjaftueshëm për ndonjë gërvishtje në programin e shkëlqyer të nivelit të lartë mbretëror. (DW)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Real Madridi bëhet skuadra me më shumë penallti në favor në historinë e Ligës së Kampionëve

MADRID, 17 SHTATOR - Real Madridi ka mposhtur Olympique de Marseille me rezultat 2-1 në një ndeshje të Ligës së Kampionëve të vendosur nga dy penallti të shndërruara në gol nga Kylian Mbappe. Dhënia e penalltisë së dytë

për shkak të prekjes me dorë të Facundo Medinas ka shkaktuar shumë polemika në Francë. “Penalltia e dytë ishte pak e sikletshme dhe do ta thosha këtë nëse do të më ishte dhënë mua”, ka thënë trajneri i Marseilles, Roberto de Zerbi, pas ndeshjes.

Ndërsa Alexis Maria Martin-Tamayo Blazquez, një ekspert i të dhënave dhe statistikave në Onda Cero dhe ESPN të njohur si MisterChip, ka raportuar në “X” se me këtë penallti të dytë, Real Madridi e ka tejkaluar Bayern Munich si skuadra me më shumë

penallti të dhëna në historinë e Ligës së Kampionëve të UEFA-s. Real Madridi tani mban rekordin me 63 penallti të akorduara në favor të tyre, ndërsa pas tij vjen Bayern Munichu me 62 penallti dhe Barcelona me 56 penallti.



KOMBËTARJA U19 E VAJZAVE NIS GRUMBULLIMIN, SOT LUAN NDESHJE TESTUESE ME KOMBËTAREN A

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kombëtarja e Kosovës U19 në konkurrencën e vajzave ka nisur grumbullimin e shtatorit si pjesë e përgatitjeve për ndeshjet miqësore ndaj Malit të Zi që zhvillohen në fund të tetorit si dhe për sfidat kualifikuese të Ligës A për Kampionatin Evropian që e presin në nëntor. Në kuadër të këtij grumbullimi, Dardanet U19 do të luajnë edhe një ndeshje testuese me Kombëtaren A të Kosovës, sot (e enjte), në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Përzgjedhësja Albina Rrahmani është shprehur e kënaqur me këtë fazë përgatitore, duke e

konsideruar si një mundësi të mirë për ta parë nga afër formën e futbollisteve. “Ky është një kamp shumë i mirëseardhur, edhe pse është jashtë datave të UEFA-s e FIFA-s. Falë bashkëpunimit me Kombëtaren A do të zhvillojmë një ndeshje testuese që do të na ndihmojë ta shohim potencialin e vajzave, ndërkohë që kjo ndeshje i shërben edhe ekipit A. Në fund të tetorit do të kemi dy miqësore me Malin e Zi, ndërsa në nëntor na presin ndeshjet kualifikuese që do të jenë shumë të vështira, pasi kemi përballë ekipe shumë të forta si Portugalia, Danimarka dhe Islanda. Megjithatë, po



mundohemi t'i përgatisim sa më mirë këto vajza dhe të paraqitemi sa më mirë. Është një gjeneratë që ka përvojë në ndeshje ndërkombëtare, pasi ka luajtur nga U15 në turne zhvillimor të UEFA-s, pastaj disa prej tyre kanë qenë edhe në U17 që kanë luajtur ndeshje

po aq të forta. Prandaj po shpresojmë se kjo përvojë e tyre do të ndikojë për të mirë në ekipin tonë”, ka thënë Rrahmani. Ndërkohë futbollistja Olsa Maqastena ka theksuar se atmosfera në ekip është shumë pozitive dhe grupi është i

përgatitur për sfidat. “Jemi një grup i mirë dhe kemi pritur me shumë kënaqësi edhe disa vajza që i janë bashkuar ekipit nga jashtë. Atmosfera është në nivel dhe stërvitjet po shkojnë shumë e mirë. Në muajin tetor i kemi ndeshjet miqësore në Mal të Zi. Jemi përballë edhe më herët me Malin e Zi dhe sigurisht se këto miqësore do të na ndihmojnë shumë për ndeshjet kualifikuese të nëntorit, ku kemi përballë kundërshtarë të nivelit të lartë. Por ne edhe më herët jemi përballur me kundërshtarë të këtij niveli në gjeneratat e mëhershme dhe jemi të gatshme për sfidat që na presin”, ka thënë Maqastena.

FC DRENICA: MBËSHTESIM 100 PËR QIND TRAJNERIN BYLBYL SOKOLI



SKENDERAJ, 17 SHTATOR - FC Drenica ka reaguar në rrjetet sociale ndaj një grupi të tifozëve të skuadrës të cilët kanë kërkuar shkarkimin e trajnerit Bylbyl Sokoli. Grupi i tifozëve “Shqiponjat e Zeza” ka kërkuar shkarkimin e trajnerit Sokoli për rezultatet e dobëta dhe arrogancën, sipas tyre, të shprehur ndaj tifozëve. Klubi në reagimin zyrtar këtë deklaratë e ka quajtur tendencioze, me synim që ta dëmtojë skuadrën dhe se nuk

do ta lejojë ndërhyrjen nga jashtë nga persona të caktuar. “Deklarata e publikuar nga një grup i caktuar brenda klubit të tifozëve është tendencioze, dashakeqe dhe aspak e rastësishme. Qëllimi i saj është i qartë: ta dëmtojë klubin në prag të ndeshjeve të rëndësishme që na presin. Kryesia, kryetari dhe zëvendëskryetari i klubit janë 100 për qind pas trajnerit Bylbyl Sokoli dhe lojtarëve tanë. Për herë të parë FC Drenica ka një

kryesi të fortë, me vendime që nuk lejojnë ndërhyrje nga jashtë. Pikërisht kjo nuk u pëlqen disa personave të caktuar të cilët mund të kenë synime të këqija. Ne e bëjmë të qartë se nuk i marrim për bazë reagimet e orkestruara të cilat nuk përfaqësojnë vullnetin e tifozëve të vërtetë të Drenicës. Klubi vazhdon rrugëtimin e tij me unitet, përkushtim dhe besim të plotë në stafin dhe futbollistët tanë”, është thënë në reagimin e FC Drenica.

Mourinho pranë marrëveshjes me Benfican

LISBON, 17 SHTATOR - Jose Mourinho është në bisedime të avancuara për ta marrë drejtimin e skuadrës portugeze, Benfica. Trajneri portugez, që është shkarkuar në fund të gushtit nga Fenerbahçe, pritët ta zëvendësojë Bruno Lagen.

Lage është shkarkuar të martën mbrëmë menjëherë pasi Benfica është mposhtur nga Qarabagu në ndeshjen e parë të fazës së ligës në Ligën e Kampionëve. Benfica është rivali i përbetuar i Portos, ekip me të cilin Mourinho ka shkruar histori

në vitin 2004 duke e fituar Ligën e Kampionëve. Pikërisht, ky ishte fillimi i një karriere të madhe për 62-vjeçarin. Madje sivjet ishte Benfica që e ka eliminuar Fenerbahçen nga plejofi për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve gjë që ka sjellë

largimin e Mourinhos nga Turqia. Ai kishte drejtuar Benfican në vitin 2000 për një periudhë të shkurtër. Mourinho ka qenë trajner edhe te Chelsea, Interi, Real Madridi, Manchester Unitedi, Tottenham Hotspuri dhe Roma.



Zhegrova me statistika impresionuese në debutim me Juventusin në Champions

Edon Zhegrova debutoi mbrëmë në fanellën e Juventusit duke e bërë kështu rikthimin në fushën e blertë pas nëntë muajsh. Ylli kosovar nuk po luante që nga dhjetori i vitit të kaluar shkaku i një lëndimi, ndërsa mbrëmë e dha kontributin e tij në rikthimin e madh në Ligën e Kampionëve. Juve ishte duke humbur 2:4 dhe menjëherë u vërejt efekti i inkuadrimit në lojë të përfaqësuesit kosovar, shkruan

“Gazeta Express”. “Bianconeri” bënë rikthim sensacional duke shënuar dy herë në minutat shtesë për të barazuar në fund në 4:4. E pas lojës janë zbuluar edhe statistikat e ish-futbollistit të Baselit dhe të Lille, i cili luajti 11 minuta. 26-vjeçari i pati 15 prekje të topit në këtë periudhë, ndërsa e kishte një duel të fituar dhe i kishte pasimet 75% të sakta. Një debutim pozitiv që është

vlerësuar lart edhe nga tifozët Bardhezi. Trajneri Igor Tudor e përfshiu në listë befasisht Zhegrovën pasi pritej që ai ta fitonte ftesën e parë vetëm në fundjavë në Serie A. Sidoqoftë, anësori ofanziv pritet të ketë gjithnjë e më shumë hapësira tek ekipi i ri, ndërsa do të mundohet ta tregojë veten siç ka bërë edhe tek Lille, ku ishte njëri prej lojtarëve më të mirë të ekipit.



SUKSESET E KOSOVËS NË KARATE NË ARENËN NDËRKOMBËTARE VAZHDOJNË: E DYTA NË MESDHETARE NË SPANJË



Kosova ka shënuar suksesin e radhës në karate në Mesdhetaren e Spanjës, duke u radhitur e dyta. Kampionati i mbajt në qytetin e Guadalajra të Spanjës ku Kosova u rendit menjëherë pas Spanjës. “Garuesit tanë, me shpirtin e tyre luftarak dhe me sjelljen

shembullore sportive, i sollën Kosovës medalje dhe krenari. Me 49 garues pjesëmarrës, arritëm të fitojmë 7 medalje të arta, 4 të argjendta, 5 të bronzta dhe 7 vende të pesta. 16 shtete pjesëmarrëse me 582 dhe 648 paraqitje nga tri kontinente”, thuhet në njoftim.

Senior/e Individuale MEDALISTËT

Betim Maliqi Male Kumite -75kg
Diellza Sejdiqaj Female Kumite +68kg
Fortesa Orana Female Kumite +68kg

Seniorët/et Plasmanet

Albulena Gërvalla Kumite -50kg vendi i 5-të
Qendresa Ibrahimit Kumite -61kg vendi i 5-të
Jakup Ajdari Male Kumite -84kg vendi i 5-të

Junior/e Individuale MEDALISTËT

Korab Gashi Kumite Male -76kg
Aid Curri Kumite Male -68kg
Suela Arifi Kumite Female -59kg
Blerand Osmani Male Kumite +76kg
Lijana Iseni Female Kumite -66kg
Dea Hasanaj Female Kumite -53kg

Juniorët/et Plasmanet

Haris Mustafa Kumite -68kg vendi i 5-të
Suela Halimi Kumite -53kg vendi i 5-të

Kadetët/et Individuale MEDALISTËT

Lanika Rexhepi Female Kumite +61kg
Priyam Gashi Male Kumite +70kg
Rion Bahtiri Male Kumite +70kg

Kadetët/et Plasmanet

Almir Pollomi Kumite -57kg vendi i 5-të

EKIPORET

Male Team Kumite Junior

Aid Curri
Blerand Osmani
Korab Gashi
Erblin Shoshi

Male Team Kumite Cadet

Almir Pollomi
Anuar Krasniqi
Rion Bahtiri
Priyam Gashi

Female Team Kumite Juniors

Suela Halimi
Lijana Iseni
Suela Arifi
Alina Kurti

EVROPIANI 2027 SHQIPËRI – SERBI, KY ËSHTË VEPRIMI I FUNDIT I UEFA-S

Në kuadër të përgatitjeve për organizimin e Kampionatit European U21 2027, një grup pune i UEFA-s ka zhvilluar një vizitë në Shqipëri në datat 8-12 shtator. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të inspektuar stadiumet e ndeshjeve, terrenet stërvitore dhe hotelet ku pritet që të akomodohen ekipet

pjesëmarrëse. Zyrtarët e UEFA-s të shoqëruar nga përfaqësues të FSHF, kanë vizituar stadiumet që do të mirëpresin këtë kampionat historik. Përshtypja e përgjithshme e inspektorëve të UEFA-s ishte pozitive, ndërkohë që paralelisht janë vizituar edhe 28 hotele si dhe 21 qendra stërvitore, të cilat

do të vlerësohen nga UEFA e do të formësohen në “Team Base Camp”-s për katalogun që do t’u ofrohet ekipeve finaliste. Vizita e radhës e UEFA-s është planifikuar në mars të viti 2026 për të parë sërish ecurinë e këtij projekti madhështor, shkruan abcnews. Komitetit Ekzekutiv i UEFA-s vendosi në shkurt të këtij viti që

Shqipëria të jetë një nga vendet organizatore të Kampionatit European U-21 të vitit 2027. Ky turne, i cili do të zhvillohet në qershor të vitit 2027, do të përfshijë 16 skuadra që përfaqësojnë talentet më të spikatura të futbollit të moshave në Europë, mes tyre edhe lojtarë që tashmë aktivizohen në ligat më të mira të kontinentit.



MBAPPÉ E ARRIN 50 GOLËSHIN TEK REALI, I CILI E REGJISTROI FITOREN E 200-TË NË CHAMPIONS



Kylian Mbappé ka nisur ta shkruajë historinë tek Real Madridi duke i dhuruar rekorde të reja klubit spanjoll. Falë dygolëshit të tij nga penalltia kundër Olympique Marseillet të Roberto De Zerbit, sulmuesi francez ua siguroi “Los Blancos” fitoren e 200-të në Ligën e Kampionëve, një arritur që s’e ka shijuar asnjë skuadër evropiane. Kjo fitore, nënvizon mediumi spanjoll “AS”, e shënon edhe një

arritje tjetër prestigjioze: Real Madridi e ka kaluar kuotën e 700 golave në garën më të madhe evropiane, numra që e vulosin fuqinë ofanzive të skuadrës dhe pozicionimin unik të klubit madrilen në panoramën kontinentale, përcjell “Gazeta Express”. I vendosur në pozitën e qendërsulmuesit, Mbappé në mënyrë konstante e vuri në vështirësi mbrojtjen marsejeze.

Pavarësisht mungesës së rasteve të pastra, sulmuesi e ruajti qetësinë në momentet vendimtare duke i shënuar me siguri të dy penalltitë dhe duke e vendosur në fakt një ndeshje mjaft të komplikuar për djelmoshat e trajnerit Xabi Alonso. Paraqitja e kampionit të botës 2018 e nënvizon edhe një herë rolin e tij të protagonistit në net të mëdha evropiane dhe e

konfirmoi faktin se si Real Madridi është në gjendje t’i përmbysë dhe t’i rikthejë ndeshjet më delikate. Ish-futbollisti i Monacos dhe i Paris Saint-Germainit, ndër të tjera, e arriti numrin jubilar prej 50 golash me “Merengues” në vetëm 64 paraqitje. Vetëm Cristiano Ronaldo kishte bërë më mirë, duke e arritur këtë shifër golash në 53 ndeshje të zhvilluara me madrilenët.

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

IAAP "LASGUSH PORADECI" KIJEVË

Datë: 09/09/2025

Nr. Prot. 8921/25

IAAP "Lasgush Poradeci" Kijevë

Adresa: Rruga "Imer Krasniqi" pn.

shmplasgushporadeci@gmail.com

Bazuar në UA NR. 02/2016 të MASHT, për aktivitetet jashtëshkollore, IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

(Ekskursion 5 ditor jashtë vendit - Shqipëri)

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë ftesë për oferta për përzgjedhjen e agjensionit të udhëtimit dhe akomodimit për organizimin e Ekskursionit 5 ditor në Republikën e Shqipërisë me maturantët për vitin shkollor 2025/26

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 netë / 5 ditë, me pansion të plotë.

Agjensioni turistik duhet ti plotësojë këto parakushte:

1. Kompania (agjensioni) turistik duhet të jetë i licensuar,

2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore,

3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve,

4. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve,

5. Kompania (agjensioni) turistik duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjeksisë) që i shoqëron nxënësit,

6. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dokumentacionin (licensën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të nënshkruar dhe të vulosur nga pronari i hotelit,

7. Kontrata në mes të hotelit dhe Kompanis (agjensionit) turistik,

8. Kompania (agjensioni) turistik duhet të prezantojë menynë ditore të ushqimit për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të nënshkruar dhe të vërtetuar nga pronari i hotelit,

9. Një fletë konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë turistike dhe hotelit me datë të caktuar,

10. Licensa e autobusit dhe vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të arrijnë,

11. Vërtetim i ATK-së,

12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional,

13. Agjensioni duhet ti mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike,

14. Të kihet parasysh numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma.

Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë ku dhe do të vendoset për ofertën dhe vendin (hotelin) e vendosjes së nxënësve, nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertave.

VËREJTJE: OFERTAT TË CILAT NUK I PËRMBUSHIN KRITERET E KËRKUARA NUK DO TË MERREN NË SHQYRTIM.

Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes së ofertës,

Ofertat pranohen në sportelet e DKAE – së në komunën e Malishevës,

Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00 në shkollë.

Kijevë 09/09/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS

Mësimi Profesional "Lasgush Poradeci"

Kijevë

SHKOLLË E MALISHEVËS

Drejtori. Msc. Burim Gashi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Micom-M Plus" SH.P.K. me seli në Leposaviç, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810699655 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Micom-M Plus" D.O.O. Leposavic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810699655 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Micom-M Plus" L.L.C. with headquarters Leposaviç, has come to the decision to quit its business: 810699655 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qëndrim Hoxha shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të shm mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Zivinarska Farma Pilke" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 811814848.

- Liridona Maxhunaj shpall të pavlefshme dëftesat e shfmu "Selman Riza" Gjakovë.

- Marigona Bahtiri shpall te pavlefshme diplomën me nr. 71 drejtimi Inxhinieri Ekonomike – Master Fakulteti "Isa Boletini" arsyeya ndërrim mbiemri.

- Ismet Tahiraj shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Zekiria Rexha" Gjakovë nga kl. 1-8.

- Labinot Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmle "Hasan Prishtina.

- Behar Hyseni shpall të pavlefshme diplomën e shm mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Sabit Beqiri shpall te pavlefshme diplomën e shmle "Hasan Prishtina".

- Rozvita Deda shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë drejtimi Farmaci.

- Saniye Ibrahim shpall te pavlefshme diplomën e shmle "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".

- Berneta Boshnuaku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Rinor Xhemajli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Fazli Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Dëshmorët e Dushkajes" Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.

- Edin Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "28 Nëntori" Brodosan.

- Mërgim Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Dëshmorët e Dushkajes" Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Burim Toast" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811919466 Prishtinë.

- Adriatik Kokalla shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

